



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 36, datë 30.03.2026

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË SUBJEKTIT ZHVILLUES PËR OBJEKTIN:
“KOMPLEKS REZIDENCIAL DHE TURISTIK 1, 2, 3 DHE 4 KATE MBI TOKË DHE 2
KATE NËNTOKË, “DELTA GARDENS”, ME VENDNDODHJE NË PALASË, BASHKIA
HIMARË”

Në mbështetje të neneve 27, 28, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit” i ndryshuar, nenit 13/1 të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; me propozim të subjektit zhvillues “Golden Key” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e subjektit zhvillues për objektin: “Kompleks rezidencial dhe turistik 1, 2, 3 dhe 4 kate mbi tokë dhe 2 kate nëntokë, “Delta Gardens”, me vendndodhje në Palasë, Bashkia Himarë”, të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit me Nr. 36, datë 30.03.2026 nga shoqëria “White Roads Hotel” sh.p.k në shoqërinë “Golden Key” sh.p.k.
2. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyjnë në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTRISË SË TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT

BLENDI GONXHJA



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 15/04/2026